



qendra e provimeve

**KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE  
NË FUND TË CIKLIT TË TRETË  
TË SHKOLLËS FILLORE**

# **KATALOGU I PROVIMIT GJEOGRAFI**

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

### Katalogun e provimit e përgatitën:

**Nada Maras**, Enti për Shkolla  
**Vesna Kekoviq**, SHF „Kekec“ - Sutomore  
**Sllagjana Foliq**, SHF „ Dr. Dragisha Ivanoviq“ – Podgoricë  
**Zoran Pejoviq** , Gjimnazi „ Slllobodan Shkeroviq“ – Podgoricë  
**Dragoje Gjokiq**, Qendra e Provimeve

Recensente:

**Dr. Dragica Mijanović**

Konsulent profesional:

**Nikollë Dukaj**, profesor i lëndës

Përktheu:

**Luigj Berisha**

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

### PËRMBAJTJA

<b>1.</b> HYRJE .....	4
<b>2.</b> RREGULLAT.....	5
<b>3.</b> QËLLIMET E PËRGJITHSHME TË PROVIMIT.....	6
<b>4.</b> STRUKTURA E PROVIMIT.....	7
<b>5.</b> PROGRAMI I PROVIMIT.....	9
<b>6.</b> SHEMBULLI I TESTIT ME SKEMË PËR PIKËZIM .....	14
<b>7.</b> LITERATURA.....	24

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

# 1. HYRJE

*Provimi ekstern për nxënësit e klasës IX të shkollës fillore (Matura e Vogël) është kontrollim ekstern i standardizuar i të arriturave shkollore të nxënësve në fund të ciklit të tretë të arsimit fillor. Një vendim i këtillë ka gjetur mbështetje në Ligjin për shkollën fillore, neni 56 ("Fl. Zyrtare e RMZ", nr. 64/02 e 28. 11. 2002, 49/07 e 10. 08. 2007, dhe "Fl. Zyrtare e Malit të Zi, nr. 45/10 e 04. 08. 2010).*

*Kontrollohen njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë të cilat bazohen në pjesët kryesore të programit të lëndës së historisë, kurse duhet t'i kenë nxënësit në fund të shkollës fillore.*

*Përgatitjen e detyrave e bën Qendra e Provimeve, derisa kontrollimin e dijes e bën Qendra e Provimeve në bashkëpunim me shkollën. Mënyrën dhe procedurën e kontrollimit të dijes së nxënësve e përcakton Ministria e Arsimit.*

*Në provimin ekstern të nxënësve të klasës së nëntë, Gjeografia është lëndë të cilën e zgjedh nxënësi nga lista e lëndëve të detyruara.*

*Katalogu i provimit hollësisht e përshkruan provimin nga Gjeografia dhe u kushtohet nxënësve dhe mësuesve.*

*Në Katalogun e provimit janë cekur qëllimet e përgjithshme të provimit, është përshkruar struktura e provimit, kurse përmes formës së qëllimeve të provimit saktësisht është thënë përmbajtja e lëndës që i nënshtrohet provimit. Është dhënë edhe shembulli i testit me skemën e hollësishme për vlerësim.*

## 2. RREGULLAT

Të gjithë nxënësit të cilët e kanë zgjedhur Gjeografinë nga lista e lëndëve të detyruara në provimin ekstern për nxënësit e klasës IX, do të japin provimin të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë.

Është paraparë që nxënësi të ulet vetëm në bankë dhe që renditja e bankave në klasë të jetë e tillë që më së shumti në një hapësirë të vendosen 15 nxënës.

Materiali i provimit do të paktohet në qese të veçanta dhe të sigurta (PVC), të cilat do të hapen para nxënësve para fillimit të provimit.

Në provim nuk lejohet:

- prezantimi i rrejshëm
- shikimi i detyrave të provimit para kohës së lejuar
- pengimi i nxënësve tjerë
- përshkrimi nga nxënësi tjetër
- shfrytëzimi i mjeteve të palejuara
- mosrespektimi i sinjalit për përfundimin e provimit

**Mjetet e lejuara** janë: lapsi i thjeshtë, goma, lapsi kimik dhe korrektori.

Punimi i nxënësit duhet të jetë i shkruar me laps kimik.

## 3. QËLLIMET E PËRGJITHSHME TË PROVIMIT

Qëllimi i provimit ekstern në fund të klasës së nëntë (Matura e vogël) nga Gjeografia është që:

- të kontrollojë njohuritë nga Gjeografia dhe aftësitë e arritura gjatë shkollimit në shkollën fillore, të cilat janë përkufizuar përmes standardeve arsimore të lëndës dhe me këtë katalog;
- të kontrollojë nëse nxënësi zotëron njohuritë e proceseve natyrore-gjeografike dhe proceset shoqërore-gjeografike dhe dukuritë që paraqiten në rrafshin lokal, rajonal dhe atë planetar dhe ndikimin e tyre në mes vetes;
- të vërtetojë nëse nxënësi i kupton paraqitjet e dukurive më të rëndësishme dhe procesin përmes shembujve karakteristik të tyre dhe lidhjeve të shkakut dhe pasojës;
- të vërtetojë nëse nxënësi i kupton strukturat dhe proceset e rajoneve të ndryshme në kuadër të sistemit global;
- të vërtetojë nëse nxënësi është i njohur me veçoritë gjeografike të Malit të Zi;
- të vërtetojë nëse nxënësi ka fituar dije për parandalimin, mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor;
- të aftësojë nxënësin për procesin e arsimit të vazhdueshëm;
- të krahasojë të arriturat e njohurive dhe aftësive nga Gjeografia në nivelin shkollor dhe nacional.

## 4. STRUKTURA E PROVIMIT

Numri maksimal i pikëve është **100**. Detyra që nuk është zgjidhur saktë ose ajo që nuk është kryer **nuk sjell** pikë negative.

Provimi përmban dy lloj detyrash:

- A. detyrat me zgjedhje të shumëfishtë
- B. detyrat e tipit të hapur

Tipi i detyrave	Numri i detyrave
Detyrat e tipit të hapur	15 - 20
Detyrat e tipit të mbyllur	10 -20

Lënda mësimore nga Gjeografia për shkollën fillore është e ndarë në 4 kapituj (fusha). Me tabelë është dhënë përfaqësimi i përmbajtjes në strukturë të provimit.

Numri rendor	Kapitulli	Përfaqësimi i përmbajtjes me %
1.	Gjeografia e përgjithshme fizike dhe shoqërore (klasa VI dhe dy temat e para të klasës VII)	20%
2.	Gjeografia e Europës (klasa VII)	15%
3.	Gjeografia e kontinenteve jashtë europiane (klasa VIII)	30%
4.	<b>Gjeografia e Malit të Zi (klasa XIX)</b>	35%

# 5. PROGRAMI I PROVIMIT

## 1. GJEOGRAFIA E PËRGJITHSHME

### 1.1. HYRJE NË GJEOGRAFI

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 1.1.1. objektin e studimit të gjeografisë;
- 1.1.2. të theksojë ndërlíkueshmërinë dhe llojllojshmërinë e elementeve të mjedisit gjeografik;
- 1.1.3. të analizojë varësinë ndërmjet elementeve natyrore dhe elementeve shoqërore.

### 1.2. GJITHËSIA DHE TOKA

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 1.2.1. të përkufizojë nocionet themelore për Gjithësinë;
- 1.2.2. llojet e trupave qiellor, pozitën dhe lëvizjen e tyre;
- 1.2.3. të njohë Sistemin Diellor dhe pozitën e Tokës në të.

### 1.3. PLANETI TOKËS

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 1.3.1. formën dhe madhësinë e Tokës dhe rrugën deri te këto njohuri;
- 1.3.2. të dallojë pjesët tokësore dhe oqeanike të Tokës;
- 1.3.3. krahasojë pozitën, madhësinë, përthyerjen e kontinenteve;
- 1.3.4. të kuptojë shtresat e ndërtimit të tokës dhe përbërjen e kores së Tokës;
- 1.3.5. të dallojë format themelore të relievit;
- 1.3.6. të njohë fuqitë e brendshme dhe të jashtme dhe rolin e tyre në krijimin e relievit;
- 1.3.7. të analizojë ndikimin e njeriut në natyrë (ndikimin pozitiv ose negativ).

### 1.4. PARAQITJA E SIPËRFAQES SË TOKËS

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 1.4.1. të kuptojë nevojën dhe të dallojë metodat e paraqitjes së Tokës;
- 1.4.2. të caktojë tiparet dhe elementet e hartës gjeografike;
- 1.4.3. të dallojë hartat sipas përdorimit, përmbajtjes dhe shkallës;
- 1.4.4. të dëshmojë aftësitë e orientimit në hartë ose në natyrë:

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

### 1.5. LËVIZJA E TOKËS DHE PASOJAT E LËVIZJEVE TË SAJ

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 1.5.1. të kuptojë dhe të shpjegojë pasojat e lëvizjes dy mënyrëshe të Tokës;
- 1.5.2. të analizojë ndërrimin e stinëve të vitit dhe brezave të nxehtësisë;
- 1.5.3. të konkludojë për pasojat e lëvizjeve në gjerësitë tona gjeografike dhe ndikimin në jetën dhe punën.

### 1.6. MBËSHTJELLËSI AJROR I TOKËS

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 1.6.1. të informojë për përbërjen dhe strukturën e atmosferës;
- 1.6.2. të vlerësojë rëndësinë e atmosferës për jetën në Tokë;
- 1.6.3. të analizojë faktorët dhe elementet klimatik si dhe varësinë ndërmjet tyre;
- 1.6.4. të dallojë kohën dhe klimën dhe tipat klimatike në Tokë;
- 1.6.5. të analizojë pasojat e ndotjes së atmosferës dhe masat e mbrojtjes.

### 1.7. UJËRAT NË TOKË

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 1.7.1. të kuptojë rëndësinë e ujit për jetën në Tokë;
- 1.7.2. të dallojë llojet e ujërave;
- 1.7.3. të analizojë përthyerjen e brigjeve, vetitë dhe lëvizjet e ujit të detit;
- 1.7.4. të analizojë karakteristikat e ujërave në tokë, renditjen dhe rëndësinë e tyre;
- 1.7.5. të kuptojë problemin e mungesës së ujit të pastër dhe të zhvillojë raport kritik ndaj këtij problemi.

### 1.8. BOTA BIMORE DHE SHTAZORE

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 1.8.1. të kuptojë shtrirjen e botës bimore dhe shtazore;
- 1.8.2. të analizojë varësinë ndërmjet karakteristikave klimatike dhe të relievit dhe shpërndarjen e botës së gjallë;
- 1.8.3. të shpjegojë raportin e njeriut dhe vegjetacionit dhe nevojën e mbrojtjes.

### 1.9. POPULLSIA DHE VENDBANIMET NË TOKË

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 1.9.1. të shpjegojë ndikimin e kushteve natyrore dhe shoqërore në përhapjen e popullsisë;

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

- 1.9.2. të dallojë lëvizjen natyrore dhe hapësinore të popullsisë dhe pasojat e këtyre lëvizjeve;
- 1.9.3. të dallojë strukturën dhe karakteristikat e popullatës (gjinisë, moshës, racës, religjionit, etj.);
- 1.9.4. të ndajë rajonet e populluara nga rajonet e papopulluara si dhe shkaqet e kësaj gjendjeje;
- 1.9.5. të dallojë tipat e vendbanimeve dhe kushtet e paraqitjes së tyre;
- 1.9.6. të analizojë problemet bashkëkohore të popullatës.

### 1.10. TËRËSIA GJEOGRAFIKE DHE VEPRIMTARITË NJERËZORE

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 1.10.1. të dallojë mjedisin natyror dhe gjeografik;
- 1.10.2. të kuptojë nocionin e rajonit;
- 1.10.3. të analizojë llojet dhe rëndësinë e resurseve natyrore;
- 1.10.4. të dallojë veprimtaritë ekonomike dhe varësitë ndërmjet tyre nga kushtet natyrore dhe shoqërore.

## 2. EUROPA

### 2.1. Europa-karakteristikat natyrore dhe shoqërore

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 2.1.1. të shpjegojë pozitën gjeografike të Europës;
- 2.1.2. të përshkruaj brigjet e Europës dhe të sqarojë përthyerjen e saj;
- 2.1.3. të përmend sistemet malore dhe vargmalet dhe t'i krahasojë në mes veti;
- 2.1.4. të shpjegojë zonat klimatike në Europë;
- 2.1.5. të përmend karakteristikat themelore të bashkësive bimore dhe shtazore në Europë;
- 2.1.6. të sqarojë elementet dhe strukturat e ndryshme të popullatës europiane;
- 2.1.7. të kuptojë proceset integruese në Europë.

### 2.2. Europa Jugore

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 2.2.1. të sqarojë pozitën gjeografike të Europës Jugore;
- 2.2.2. të shpjegojë karakteristikat themelore të natyrës;
- 2.2.3. të shpjegojë elementet dhe strukturat e ndryshme të popullatës së Europës Jugore;
- 2.2.4. të vërej varësinë ndërmjet natyrës dhe ekonomisë së Europës Jugore;
- 2.2.5. të kuptojë rëndësinë e komunikacionit dhe atë turistike të Mesdheut;
- 2.2.6. të shpjegojë veç e veç karakteristikat themelore natyrore dhe shoqërore të vendeve të Europës Jugore.

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

### 2.3. Europa Perëndimore

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 2.3.1. të shpjegojë pozitën gjeografike të Europës Perëndimore;
- 2.3.2. të sqarojë vetitë themelore natyrore dhe shoqërore të Europës Perëndimore;
- 2.3.3. të kuptojë zhvillimin ekonomik;
- 2.3.4. të shpjegojë karakteristikat themelore natyrore dhe shoqërore të vendeve të Europës Perëndimore.

### 2.4. Europa e Mesme

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 2.4.1. të vlerësojë volitshmëritë e Europës së Mesme në kuptimin e reljevit, komunikacionit dhe kushtet për jetën e njerzëve;
- 2.4.2. të sqarojë rëndësinë e komunikacionit dhe atë ekonomike të Danubit;
- 2.4.3. të përmend popujt e Europës së Mesme dhe të caktojë grupin gjuhësor dhe religjioz që bëjnë pjesë;
- 2.4.4. të kuptojë varësinë ndërmjet natyrës dhe afarizmit në Europën e Mesme;
- 2.4.5. të shpjegojë karakteristikat themelore natyrore dhe shoqërore të vendeve të Europës së Mesme.

### 2.5. Europa e Veriore

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 2.5.1. të sqarojë pozitën gjeografike të Europës Veriore;
- 2.5.2. të kuptojë karakteristikat themelore natyrore të Europës Veriore;
- 2.5.3. të vërej ndikimin e klimës polare në popullimin dhe mënyrën e jetës;
- 2.5.4. të sqarojë karakteristikat themelore natyrore dhe shoqërore të vendeve të Europës Veriore.

### 2.6. Europa Lindore

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 2.6.1. të sqarojë pozitën gjeografike;
- 2.6.2. të përmend karakteristikat e popullatës dhe të shpjegojë zhvillimin ekonomik të Europës Lindore;
- 2.6.3. të shpjegojë karakteristikat themelore natyrore dhe shoqërore të vendeve të Europës Lindore.

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

**3. KONTINENTET JASHTË EUROPËS****3.1. AZIA**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.1.1. të sqarojë pozitën gjeografike të Azisë;
- 3.1.2. të analizojë përthyerjen horizontale dhe vertikale të kontinentit;
- 3.1.3. të dallojë tipat klimatike;
- 3.1.4. të sqarojë rëndësinë e rrjedhave të mëdha të ujit;
- 3.1.5. të dallojë botën karakteristike bimore dhe shtazore;
- 3.1.6. të analizojë elementet dhe strukturat e ndryshme të popullsisë;
- 3.1.7. të veçojë problemet më të rëndësishme të popullatës;
- 3.1.8. të përmend pasuritë natyrore themelore ;
- 3.1.9. të vlerësojë zhvillimin e ekonomisë;
- 3.1.10. të veçojë tërësitë rajonale në bazë të karakteristikave të tyre natyrore dhe shoqërore.

**3.2. AZIA – KURIOZITETET GJEOGRAFIKE**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.2.1. të përshkruaj Himalajet;
- 3.2.2. të përmend vlerat e Murit Kinez;
- 3.2.3. të dallojë popujt karakteristik.

**3.3. AFRIKA**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.3.1. të sqarojë pozitën gjeografike të Afrikës;
- 3.3.2. të analizojë përthyerjen horizontale dhe vertikale të kontinentit;
- 3.3.3. të krahasojë zonat klimatike dhe bimore, të japë konkluzione për kushtet për jetën;
- 3.3.4. të shpjegojë rëndësinë e rrjedhave ujore dhe liqeneve më të mëdha;
- 3.3.5. të dallojë botën karakteristike bimore dhe shtazore;
- 3.3.6. të analizojë elementet dhe strukturat e ndryshme të popullatës;
- 3.3.7. të dallojë tipat e vendbanimeve;
- 3.3.8. të veçojë problemet kryesore të popullatës;
- 3.3.9. të përmend prodhimet sipas të cilave vendet afrikane janë të njohura në botë;
- 3.3.10. të veçojë tërësitë rajonale në bazë të karakteristikave të tyre natyrore dhe shoqërore.

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

### 3.4. AFRIKA – KURIOZITETE GJEOGRAFIKE

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.4.1. të përshkruaj Saharën, Piramidat e Egjiptit;
- 3.4.2. të përshkruaj Kilimanxharon-pullazin e Afrikës;
- 3.4.3. të dallojë karakteristikat e vendbanimeve dhe popullatës.

### 3.5. AMERIKA – POZITA GJEOGRAFIKE DHE ZBULIMI

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.5.1. të shpjegojë pozitën gjeografike të Amerikës;
- 3.5.2. të sqarojë zbulimin dhe kolonizimin e Amerikës.

### 3.6. AMERIKA VERIORE

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.6.1. të analizojë përthyerjen e brigjeve të Amerikës Veriore;
- 3.6.2. të shpjegojë karakteristikat e relievit;
- 3.6.3. të dallojë zonat klimatike dhe bimore, të nxjerr konkluzione për kushte për jetën;
- 3.6.4. të sqarojë rëndësinë e rrjedhave ujore dhe liqeneve më të mëdha;
- 3.6.5. të analizojë përbërjen e popullatës;
- 3.6.6. të dallojë tipat dhe funksionet e vendbanimeve;
- 3.6.7. të përmend pasuritë natyrore më të rëndësishme;
- 3.6.8. të vlerësojë se si faktorët natyror dhe shoqëror ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë dhe zhvendosjen e veprimtarive ekonomike;
- 3.6.9. të vlerësojë rolin e SHBA-ve dhe Kanadasë në botë.

### 3.7. AMERIKA VERIORE– kuriozitetet gjeografike

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.7.1. të përshkruaj Jeloustonin – parkun e parë nacional;
- 3.7.2. të analizojë rëndësinë e Liqeneve të Mëdha dhe rrugën lundruese nëpër Sen Lorens;
- 3.7.3. të përshkruaj Kanjonin e Madh dhe të sqarojë vlerën e tij turistike;
- 3.7.4. të dallojë popullatën karakteristike.

### 3.8. AMERIKA E MESME

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.8.1. të sqarojë pozitën gjeografike;

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

- 3.8.2. të analizojë përthyerjen e brigjeve;
- 3.8.3. të shpjegojë karakteristikat e relievit;
- 3.8.4. të dallojë zonat klimatike dhe bimore, të nxjerrë konkluzione për kushtet e jetës;
- 3.8.5. të shpjegojë rëndësinë e rrjedhave ujore më të mëdha dhe liqeneve;
- 3.8.6. të analizojë përbërjen e popullatës;
- 3.8.7. të përmend prodhimet e rëndësishme me të cilat janë të njohura në botë vendet e Amerikës së Mesme.

### 3.9. AMERIKA E MESME– kuriozitetet gjeografike

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.9.1. të përshkruaj civilizimet e vjetra në Amerikën e Mesme, Majët, Astekët, Inkët;
- 3.9.2. të sqarojë rëndësinë lundruese të Kanalit të Panamasë;
- 3.9.3. të dallojë dhe të përshkruaj megalopolisin Meksiko Siti.

### 3.10. AMERIKA E JUGUT

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.10.1. të shpjegojë pozitën e Amerikës së Jugut;
- 3.10.2. të analizojë përthyerjen e brigjeve të kontinentit;
- 3.10.3. të ndajë tërësitë e mëdha natyrore dhe të shpjegojë karakteristikat e relievit;
- 3.10.4. të dallojë brezat klimatik dhe bimor;
- 3.10.5. të shpjegojë rëndësinë e rrjedhave ujore dhe liqeneve më të mëdha
- 3.10.6. të dallojë popullatën karakteristike dhe vendbanimet;
- 3.10.7. të përmend pasuritë natyrore;
- 3.10.8. të vlerësojë se si faktorët natyror dhe shoqëror ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë dhe shpërndarjen e veprimtarive ekonomike;
- 3.10.9. të përmend prodhimet e rëndësishme me të cilat vendet e Amerikës së Jugut janë të njohura në botë.

### 3.11. AMERIKA E JUGUT– kuriozitetet gjeografike

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.11.1. të përshkruaj Amazoninë dhe të shpjegojë rëndësinë e saj;
- 3.11.2. të dallojë dhe të përshkruaj Andet.

### 3.12. AUSTRALIA, OQEANIA

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

- 3.12.1. të sqarojë pozitën gjeografike të Australisë dhe Oqeanisë;
- 3.12.2. të analizojë përthyerjen e brigjeve të kontinentit;
- 3.12.3. të tregojë dhe të emërojë bashkësitë e ujdhesave të Oqeanisë;
- 3.12.4. të shpjegojë karakteristikat e relievit të kontinentit;
- 3.12.5. të zbulojë mostrat për botën karakteristike bimore dhe shtazore;
- 3.12.6. të analizojë veçoritë e ujërave;
- 3.12.7. të përmend pasuritë natyrore, të konkludojë për zhvillimin ekonomik;
- 3.12.8. të analizojë përbërjen e popullatës;

### **3.13. AUSTRALIA DHE OQEANIA – kuriozitetet gjeografike**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.13.1. të përshkruaj format karakteristike të natyrës, grumbullin e madh koral, parqet nacionale;
- 3.13.2. të dallojë popullatën karakteristike;
- 3.13.3. të përshkruaj ishujt karakteristik të Oqeanisë.

### **3.14. ZONAT POLARE – karakteristikat ekonomike dhe shoqërore**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.14.1. të shpjegojë pozitën gjeografike të Arktikut dhe Antarktikut;
- 3.14.2. të analizojë klimën polare, të konkludojë për kushtet e jetës;
- 3.14.3. të dallojë veçoritë e botës bimore dhe shtazore;
- 3.14.4. të njohë popullatën karakteristike.

### **3.15. ZONAT POLARE – kuriozitetet gjeografike**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 3.15.1. të përshkruaj zbulimet e Polit të Veriut dhe Polit të Jugut.

## **4. GJEOGRAFIA E MALIT TË ZI**

### **4.1. POZITA GJEOGRAFIKE, MADHËSIA, KUFIJTË DHE RREGULLIMI SHTETËROR I MALIT TË ZI**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.1.1. të caktojë pozitën gjeografike të Malit të Zi;
- 4.1.2. të përmend kufirin shtetëror dhe madhësinë e Malit të Zi;
- 4.1.3. të përmend rregullimin shtetëror të Malit të Zi.

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

### 4.2. MALI I ZI – formimi i territorit shtetëror

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

4.2.1 të kuptojë dhe di të shpjegojë formimin e territorit shtetëror gjatë historisë.

### 4.3. RELIEVI I MALIT TË ZI

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

4.3.1. të dallojë tërësitë e relievit të Malit të Zi;

4.3.2. të njohë kufijtë dhe dallimet e tërësive të relievit;

4.3.3. të dallojë dhe të klasifikojë format e relievit në Mal të Zi;

4.3.4. të njohë vetitë e rajoneve shkëmbore (karstike).

### 4.4. MALI I ZI – veçoritë natyrore – rajoni i bregdetit

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

4.4.1 shtrirjen e rajonit bregdetar dhe e identifikon (në kuadër të ndarjes) tërësitë kryesore të relievit;

4.4.2. të vërej të veçantat e Gjirit të Kotorit;

4.4.3. të lidhë, të shpjegojë dhe të konstatojë për kushtet e jetës në rajonin e bregdetit.

### 4.5. MALI I ZI – veçoritë natyrore – rajoni i shkëmbinjve të thellë

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

4.5.1 shtrirjen e rajonit të shkëmbinjve të thellë;

4.5.2. të dallojë format e relievit në shkëmbinjte e Malit të Zi – sipërfaqësoret dhe nëntokësoret;

4.5.3. fushat karstike dhe rëndësinë e tyre;

4.5.4. të analizojë kushtet e jetës;

4.5.5. ndikimin dhe rëndësinë e ekzistimit të disponueshmërisë për punimin e tokës.

### 4.6. MALI I ZI – veçoritë natyrore – lugaja e pjesës së mesme të Malit të Zi

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

4.6.1 përfshirjen dhe mënyrën e krijimit të lugajës;

4.6.2. të shpjegojë pozitën gjeografike të rrafshinës së Zetës Bjellopavliqit, fushës së Nikshiqit dhe Dugës;

4.6.3. të kuptojë kushtet natyrore.

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

**4.7. MALI I ZI – veçoritë natyrore – rajoni malor**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.7.1. rajonet e dinarike në Mal të Zi;
- 4.7.2. të dallojë format tektonike dhe erozive të relievit;
- 4.7.3. malet më të rëndësishme, luginat dhe ultësirat e lumenjve dhe vlerëson rolin e tyre në hapësirë;
- 4.7.4. resurset natyrore të rajoneve;
- 4.7.5. kushtet e jetës në këtë rajon.

**4.8. KLIMA E MALIT TË ZI**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.8.1. të shpjegojë ndikimin e faktorëve klimatik në klimën e Malit të Zi;
- 4.8.2. të njohë tipat e klimës dhe vetitë e tyre;
- 4.8.3. të vërej dallimet në mes të disa tipave të klimës.

**4.8. UJËRAT E MALIT TË ZI**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.9.1. të përmend faktorët që ndikojnë në pasurinë ujore të Malit të Zi;
- 4.9.2. të përshkruaj karakteristikat themelore të Detit Adriatik ;
- 4.9.3. të dallojë liqenet sipas mënyrës së krijimit dhe pozitës;
- 4.9.4. të emërojë lumenjtë më të mëdhenj të Malit të Zi dhe t'i radhisë sipas derdhjes;
- 4.9.5. të njohë veçoritë hidrologjike të shkëmbit (karstik);
- 4.9.6. të vlerësojë vlerën ekonomike të ujërave në Mal të Zi.

**4.10. BOTA BIMORE DHE SHTAZORE, TOKA**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.10.1. të dallojë llojet e tokës dhe të vlerësojë rëndësinë e tokës për bujqësinë;
- 4.10.2. të numërojë faktorët që ndikojnë në llojlojshmërinë dhe përhapjen e botës bimore dhe shtazore;
- 4.10.3. të kuptojë pasojat e veprimtarisë njerëzore në botën bimore dhe shtazore.

**4.11. MALI I ZI – veçoritë natyrore – parqet nacionale**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.11.1. të emërojë parqet nacionale në Mal të Zi dhe të shpjegojë rëndësinë e tyre;
- 4.11.2. tiparet karakteristike të çdo parku nacional;
- 4.11.3. mënyrën e administrimit dhe menaxhimit me parkun nacional.

**KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI****4.12. MALI I ZI - POPULLATA**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.12.1. të analizojë lëvizjen e numrit të popullatës në nivel të shtetit dhe nëpër rajone, të nxjerrë përfundime;
- 4.12.2. të shpjegojë lëvizjen e popullatës rurale dhe urbane dhe problemet kryesore të tyre;
- 4.12.3. të analizojë zhvendosjen hapësinore dhe shkaqet dhe pasojat e tij;
- 4.12.4. të kuptojë shkaqet e migrimeve masive në të kaluarën dhe në kohën më të re.

**4.13. MALI I ZI – veçoritë shoqërore – vendbanimet**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.13.1. të dallojë llojet, funksionet dhe tipat e vendbanimeve dhe mëson ndikimin e qytetërimeve tjera në krijimin dhe zhvillimin e vendbanimeve dhe përse njihen ato;
- 4.13.2. të nxjerrë përfundimin përse Cetina përkatësisht Podgorica janë metropol përkatësisht kryeqytet, të përshkruajë dhe të sqarojë funksionin e Podgoricës, Cetinës dhe vendbanimeve tjera;
- 4.13.3. të vërejë problemet bashkëkohore të vendbanimeve rurale dhe urbane.

**4.14. EKONOMIA E MALIT TË ZI**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.14.1. të shpjegojë ndikimin e faktorëve natyror dhe shoqëror në zhvillimin e ekonomisë në Mal të Zi;
- 4.14.2. të vlerësojë rëndësinë dhe rolin e disa veprimtarive ekonomike;
- 4.14.3. të dallojë problemet bashkëkohore të ekonomisë;
- 4.14.4. të konkludojë cilat janë perspektivat e zhvillimit ekonomik të Mal të Zi.

**4.15. RAJONET E MALIT TË ZI**

Qëllimet e provimit

Nxënësi tregon se di:

- 4.15.1. të përmend kufijtë dhe veçoritë e rajoneve gjeografike në Mal të Zi;
- 4.15.2. të shpjegojë veçoritë natyrore dhe shoqërore të rajonit;
- 4.15.3. të krahasojë rajonet e Malit të Zi sipas veçorive specifike;
- 4.15.4. mundësitë e zhvillimit.

## 6. SHEMBULLI I TESTIT

**Në detyrat në vazhdim qarko shkronjën para përgjigjes së saktë.**

1. Në cilën paralele ndodheni nëse Dielli në mesditë është saktësisht mbi kokën tuaj dhe atë me 22 dhjetor?

- A) ekuator
- B) tropikun jugor
- C) tropikun verior

*1 pikë*

2. Çka është lymërishta?

- A) varrezë elefantash
- B) pyll i dendur dhe i errët
- C) tokë jopjellore
- D) meandër e shkëputur e lumit

*1 pikë*

3. Popullata bashkëkohore migron më së shpeshti për:

- A) shkaqe ekonomike
- B) shkaqe politike
- C) nevoja shëndetësore

*1 pikë*

KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

4. Në cilin kontinent janë krijuar religjionet e mëdha, krishterimi, islami dhe budizmi?

- A) Afrikë
- B) Amerikë
- C) Azi
- D) Evropë

*1 pikë*

5. Pjesa më e madhe e Evropës ndodhet në:

- A) brezin jugor të ftohtë
- B) brezin jugor të mesëm
- C) brezin verior të mesëm
- D) brezin e zjarrtë

*1 pikë*

6. Cili kontinent e ndan ekuatorin?

- A) Antarktiku
- B) Azia
- C) Evropa
- D) Amerika e Veriut

*1 pikë*

7. Liqeni i Bajkallit është:

- A) në lartësinë më të vogël mbidetare
- B) në lartësinë më të madhe mbidetare
- C) më i thelli
- D) më i madhi

KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

1 pikë

8. Sipas pozitës gjeografike Mali i Zi është vend:

- A) ballkanik, i Adriatikut, i Europës Jugore
- B) ballkanik, i Europës së Mesme, dhe Adriatikut
- C) i Europës Jugore, Fushës së Danubit dhe Mesdheut
- D) i Panonisë, i Evropës Jugore dhe Mesdheut

1pikë

9. Cila fushëgropë ndodhet **në** luginën e lumit Lim?

- A) E Andrijevicës
- B) E Beranit
- C) E B. Poles
- D) E Plevles

1 pikë

10. Sa përqindje e popullatës së Malit të Zi janë të punësuar në bujqësi?

- A) 9%
- B) 19%
- C) 29%
- D) 39%

1 pikë

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

**Në detyrat në vazhdim çdo kuptimi në kolonën e majtë mund t'i bashkoni vetëm një nocion nga kolona e djathtë. Duhet që mbi vija pranë numrit që tregon kuptimin në kolonën e majtë të shënoni shkronjën e përgjigjes së saktë nga kolona e djathtë. Keni kujdes, një përgjigje në anën e djathtë është e tepërt!**

11. Bashkoni?

- |             |                        |
|-------------|------------------------|
| 1. Jupiteri | A) planeti më i largët |
| 2. Neptuni  | B) planeti më i madh   |
| 3. Venera   | C) planeti me biosferë |
| 4. Toka     | D) planeti me unazë    |
|             | E) planeti pa satelit  |

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

3) \_\_\_\_\_

4) \_\_\_\_\_

4 pikë

12. Bashkoni çiftet gjegjëse:

- |             |              |
|-------------|--------------|
| 1. Gjermanë | A) baskishte |
| 2. Romanë   | B) frënge    |
| 3. Sllovenë | C) kroate    |
|             | D) gjermane  |

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

3) \_\_\_\_\_

3 pikë

KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

13. Bashkoni objektet gjeografike ose vetitë (ekonomike apo kulturore) me njërën nga vendet e dhëna.

- |                     |              |
|---------------------|--------------|
| 1. Kulla e Ajfellit | A) Danimarka |
| 2. Akropoli         | B) Franca    |
| 3. Koloseumi        | C) Greqia    |
| 4. Korida           | D) Italia    |
| 5. Kubet Lego       | E) Spanja    |
|                     | F) Suedia    |

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

3) \_\_\_\_\_

4) \_\_\_\_\_

5) \_\_\_\_\_

5 pikë

14. Cilit grup, sipas mënyrës së krijimit të basenit të liqenit, u përkasin liqenet e mëposhtme:

- |                      |                |
|----------------------|----------------|
| 1. Liqeni i Krupës   | A) karstik     |
| 2. Liqeni i Plavës   | B) të akullt   |
| 3. Liqeni i Shkodrës | C) të lumenjve |
|                      | D) artificial  |

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

3) \_\_\_\_\_

3 pikë

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

Me kujdes lexoni pohime e dhëna dhe caktoni nëse janë të sakta (S) ose të pasakta (P).

Qarko (S) nëse mendon se pohimi është i saktë, përkatësisht (P) nëse mendon se pohimi është i pasaktë.

15. Përcaktoju ndaj pohimeve në vijim:

- |  |   |   |
|--|---|---|
| A) Të gjithë meridianet janë të njëjtë.            | S | P |
| B) Meridianet janë rrrathë të imagjinuar.          | S | P |
| C) Paralelet janë njëlloj sikur mesditësit.        | S | P |
| D) Perimetri i paraleleve zvogëlohet drejt polove. | S | P |

4 pikë

16. Përcaktoju ndaj pohimeve të mëposhtme:

- |  |   |   |
|--|---|---|
| A) Rajoni më i rëndësishëm në Afrikë është Baseni i Kongos, sepse ka klimën ekuatoriale.                       | S | P |
| B) Erërat e nxehta dhe të ftohta të cilat fryjnë nga tropiku drejt ekuatorit quhen monsunet.                   | S | P |
| C) Pjesa dërrmuese e popullatës së afrikës jeton në brigjet e lumenjve, si dhe në lartësitë e mëdha mbidetare. | S | P |
| D) Bujqësia është dega kryesore e ekonomisë së Afrikës.  | S | P |

4 pikë

17. Problemet kryesore demografike të Malit të Zi janë:

- |   |   |   |
|---|---|---|
| A) rritja e lartë natyrore                  | S | P |
| B) popullata gjithnjë e më e moshuar        | S | P |
| C) popullimi jo i barabartë i disa rajoneve | S | P |
| D) numri i lartë i popullatës së re         | S | P |

4 pikë

KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

**Pyetjet e tipit të hapur:**

18. Plotëso fjalitë:

A) Rrotullimi i Tokës rreth Diellit quhet \_\_\_\_\_.

B) Rrotullimi i Tokës rreth boshtit quhet \_\_\_\_\_.

2 pikë

19. Plotëso fjalitë:

Numri i të lindurve gjallë quhet \_\_\_\_\_ kurse të vdekur \_\_\_\_\_.

Dallimi i tyre paraqet \_\_\_\_\_.

3 pikë



20. Me ndihmë të hartës udhëtojmë me objekte ujore gjeografike nga Mali i Zi (porti i Tivarit) deri në Maltë .

Plotëso fjalinë:

Tivar, përmes Detit \_\_\_\_\_ nëpër ngushticë e \_\_\_\_\_ , e pastaj përmes Detit \_\_\_\_\_ dhe Detit \_\_\_\_\_ ,deri në Maltë .

4 pikë

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

21. Plotëso fjalinë:

Europjanë të rinj, himni i Europës quhet \_\_\_\_\_, kurse himni i Malit të Zi quhet \_\_\_\_\_.

*2 pikë*

22. Plotëso fjalinë:

Cila klimë dallohet me reshje të mëdha gjatë stinës së verës, kurse pa të reshura në dimër. Kjo është veti e klimës \_\_\_\_\_.

*1 pikë*

23. Plotëso fjalinë:

Mali i Zi i përket zonës së orës \_\_\_\_\_. Nëse në Londër është ora 12 në Mal të Zi është ora \_\_\_\_\_.

*2 pikë*

24. Plotëso fjalinë:

Gjiri më i madh në Mal të Zi është \_\_\_\_\_, kurse siujdhesa më e madhe është \_\_\_\_\_.

*2 pikë*

25. Plotëso fjalinë:

Njelmësia mesatare e Detit Adriatik është \_\_\_\_\_ ‰, çka do të thotë se në një litër ujë ndodhen \_\_\_\_\_ kripë.

*2 pikë*

26. Plotëso fjalinë:

Gurra karstike nëndetare e ujit të ëmbël quhet \_\_\_\_\_.

*1 pikë*

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

27. Shkruaji tri shtete ishullore të Europës – shtete në ujdhesa?

A) \_\_\_\_\_

B) \_\_\_\_\_

C) \_\_\_\_\_

3 pikë

28. Shkruaji tri kalime detare (kanale, moreuz) nëpër të cilat duhet të kalojnë anijet nëse udhëtojnë rrugës më të shkurtër nga Londra deri në Mombaj (Indi):

A) \_\_\_\_\_

B) \_\_\_\_\_

C) \_\_\_\_\_

3 pikë


29. Në fushat e zbrazëta të tabelës së dhënë shkruaji tipat mbizotërues të klimës që i përgjigjet rajonit të dhënë:

Rajoni	Tipi klimatik
Gadishulli Arabik	
Gadishulli Indian	
Borneo	
Kilimanxharo	
Alaska	

5 pikë

KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

30. Në hartën e Amerikës Veriore me numra janë shënuar objektet natyrore. Mbi vijat e zbrazëta shkruaje emrin përkatës!



- A) 1. \_\_\_\_\_
- B) 4. \_\_\_\_\_
- C) 6. \_\_\_\_\_
- D) 7. \_\_\_\_\_

4 pikë

31. Janë dhënë 5 breza të temperaturës së lartësive në Amerikën e Mesme. Renditi ato sipas lartësisë – nga më e ulëta deri te më e larta:

Terra fria , Terra templada , Terra nevada , Terra kaliente ,Terra helada.

- A. \_\_\_\_\_
- B. \_\_\_\_\_
- C. \_\_\_\_\_
- D. \_\_\_\_\_
- E. \_\_\_\_\_

4 pikë

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

32. Mbi vija të zbrazëta shkruaji kuptimet përkatëse nga ato që janë dhënë:

- përzierja e indianëve dhe popullatës zezake,
- popullata e Azisë Lindore dhe Juglindore,
- populli autokton i Australisë dhe Tasmanisë,
- jetojnë në Alaska,
- janë krijuar me përzierjen e rracës zezake dhe asaj europiane,
- jetojnë në shkretëtirë, kryesisht janë nomadë në kërkim të kullotave më të mira,
- kryesisht popullojnë Afrikën e Veriut,
- besojnë budizmin.

- A) Aborixhinët \_\_\_\_\_
- B) Zambosët \_\_\_\_\_
- C) Inuitët \_\_\_\_\_
- D) Beduinët \_\_\_\_\_
- E) Arabët \_\_\_\_\_

5 pikë

33. Shkruaji 3 tërësi të mëdha të relievit të cilat veçohen në Mal të Zi .

- A. \_\_\_\_\_
- B. \_\_\_\_\_
- C. \_\_\_\_\_

3 pikë

KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

34. Shkruaji tri forma të relievit gëlqeror (karstik)?


A) \_\_\_\_\_

B) \_\_\_\_\_

C) \_\_\_\_\_

3 pikë

35. Në hartën memece të Malit të Zi me numra janë shënuar tre lumenj. Pranë numrit përkatës shkruaje emrin e lumit që është shënuar me atë numër.



A) 1. \_\_\_\_\_

B) 2. \_\_\_\_\_


C) 3. \_\_\_\_\_

3 pikë


KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

36. Janë dhënë katër diagrame të klimës karakteristik për tipat e klimës që paraqiten në Mal të Zi. Nën çdo diagram shkruaje tipin e klimës që përfaqëson.


A




B



C



D



A) \_\_\_\_\_

B) \_\_\_\_\_

C) \_\_\_\_\_

D) \_\_\_\_\_

4 pikë

37. Sqaro përse Lumin Nil e quajm "oazë lumore"?

---



---

2 pikë

KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

38. Shkruaj shkurtimisht në çka mbështetet rëndësia ekonomike e Detit Adriatik.

---

---

---

---

*5 pikë*

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

## PËRGJIGJET ME SKEMË PËR PIKËZIM

1. Nën B – tropikun jugor 1 pikë
2. Nën D – meandri i ndërprerë i lumit 1 pikë
3. Nën A - shkaqeve ekonomike 1pikë
4. Nën C – Azisë 1 pikë
5. Nën C –veriut të butë 1 pikë
6. Nën B – Azisë 1 pikë
7. Nën C – më i thelli 1 pikë
8. Nën A – shtet ballkanik, i Adriatikut, Europës Jugore 1 pikë
9. Nën D- Plevles 1 pikë
10. Nën A - 9% 1 pikë
11. 1- B 1 pikë  
2 - A 1 pikë  
3- E 1 pikë  
4- C 1 pikë
12. 1- D 1 pikë  
2- B 1 pikë  
3- C 1 pikë
13. 1- B 1 pikë  
2- C 1 pikë  
3- D 1 pikë  
4- E 1 pikë  
5- A 1 pikë

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

14. 1- D 1 pikë

2- B 1 pikë

3- A 1 pikë

15. A-S 1 pikë

B- P 1 pikë

C- P 1 pikë

D- S 1 pikë

16. A- S 1 pikë

B- P 1 pikë

C- S 1 pikë

D- S 1 pikë

17. A- P 1 pikë

B- S 1 pikë

C- S 1 pikë

D- P 1 pikë

18. A) Rrotullimi i Tokës rreth Diellit quhet **revolucioni**. 1 pikë

B) Rrotullimi i Tokës rreth boshtit quhet **rotacioni**. 1pikë

19. Numri i të lindurve gjallë quhet **natalitet** ( 1 pikë), kurse i të vdekurve **mortalitet** (1pikë).  
Dallimi i tyre paraqet **rritjen natyrore** (1 pikë).

20. Tivar, përmes **Detit Adriatik**(1 pikë) nëpër ngushticën e **Otrantos**(1 pikë), e pastaj përmes Detit **Jon**(1 pikë) dhe Detit të **Mesdheut**(1pikë), deri në Maltë .

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

21. Europeanë të rinj, himi i Europës quhet, „ **Oda e gëzimit**“ ( 1 pikë), kurse himni i Malit të zi quhet, „ **Oj svijetlla majska zoro**“ ( 1pikë).
22. Cila klimë dallohet me reshje të mëdha gjatë stinës së verës, kurse pa të reshura në dimër. Kjo është veti e klimës **monsune** (1pikë).
23. Mali i Zi i përket zonës së orës së **Evropës Veriore**(1 pikë). Nëse në Londër është ora 12 në Mal të Zi është **13** ( 1pikë).
24. Gjiri më i madh në Mal të Zi është gjiri i **Bokës së Kotorrit**(1pikë), kurse siujdhesa më e madhe është **Lushtica** (1pikë).
25. Njelmësia mesatare e Detit Adriatik është **35** (1 pikë) ‰, çka do të thotë se në një litër ndodhen **35 gramë** kripë (1pikë).
26. Burimi karstik nëndetar i ujit të ëmbël quhet **vrujim (gurrë)** (1 pikë).
27. Përgjigje e mundshme: Islanda ; Britania e Madhe , Irlanda, Malta.  
Çdo shtet ishullor i shkruar saktë sjell 1pikë. Gjithsej 3 pikë.  
Renditja nuk është e rëndësishme.
28. Përgjigje e mundshme: Lamansh, Gjibraltari, Kanali i Suecit, Bab el Mandeb.  
Çdo kalim detar i shkruar saktë sjell 1 pikë. Gjithsej 3 pikë.  
Renditja nuk është e rëndësishme.

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

29.

Rajoni	Tipi i klimës
Gadishulli Arabik	<b>Shkretinore</b> (1 pikë)
Gadishulli Indian	<b>Monsune</b> (1 pikë)
Borneo	<b>Ekuatoriale</b> (1 pikë)
Kilimanxharo	<b>Malore</b> (1 pikë)
Alaska	<b>Subpolare ose polare</b> (1 pikë)

30. Përgjigje:

- A) 1. Gjiri i Hadsonit      1 pikë
- B) 4. Labradorit          1 pikë
- C) 6. Malet Apalaçe      1 pikë
- D) 7. Misisipi              1 pikë

31. Përgjigje:

- A. Terra kaliente
- B. Terra templada
- C. Terra fria
- D. Terra helada
- E. Terar nevada

Për një renditje të saktë 1 pikë, për dy renditje të sakta 2 pikë, për tri renditje të sakta 3 pikë, për katër dhe pesë renditje të sakta 4 pikë, sepse e pesta hapet vetvetiu nëse katër renditen saktë.

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

32. Përgjigjet:

- E) Aborixhinët **popull autokton i Australisë dhe Tasmanisë** 1 pikë
- F) Zambosët **përzjerja e indianëve dhe popullatës zezake** 1 pikë
- G) Inuitët **jetojnë në Alaskë** 1 pikë
- H) Beduinët **jetojnë në shkretëtirë, kryesisht janë nomadë në kërkim të kullotave më të mira** 1 pikë
- E) Arabët **kryesisht e popullojnë Amerikën Veriore** 1 pikë

33. Përgjigje e mundshme: bregdeti i Malit të Zi ose rajoni Adriatik, zona e gurit të thellë, lugina e pjesës kontinentale të Malit të Zi, malet dhe majat, Mali i Zi Verilindor.

Çdo rajon i tërësisë relievore i dhënë saktë sjell 1 pikë. Gjithsej 3 pikë.

Renditja nuk është e rëndësishme.

34. Përgjigje të mundshme: thepat shkëmborë, hurdhat, lugjet, fushat karstike, humnerat, shpellat.

Çdo formë e shkruar drejtë sjell 1 pikë. Gjithsej.

Renditja nuk është e rëndësishme.

35. Përgjigje:

- A) 1. Tara 1 pikë
- B) 2. Zeta 2 pikë
- C) 3. Moraça 3 pikë

36. Përgjigje:

A) mesdhetare( mesdhetare, adriatiko-mesdhetare, adriatiko –mesdhetare)

1 pikë

B) malore 1 pikë

C) e mesme-kontinentale 1 pikë

D) e ndryshuar-mesdhetare (e ndryshuar-mesdhetare) 1 pikë

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

37. Përgjigje të dëshirueshme: Nga të dy anët e lumit Nil gjendet shkretëtira. Lugina e Nilit është tokë shumë pjellore dhe e përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme.

Përgjigje të dëshirueshme 1 pikë

- Nga të dy antë e Lumit Nil ndodhet shkretëtira.
- Për arsye se rrjedh nëpër shkretëtirë.
- Lugina e Nilit është tokë shumë pjellore dhe e përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme.
- Lumi Nil mundëson që në luginën e tij të jetë tokë pjellore.
- Nil sjell llum pjellor.

Përveç përgjigjes së dëshirueshme pranohen edhe 2 pikë dhe përgjigje të mundshme.

- Nil kalon për shkretëtirë dhe sjell llum pjellor.
- Nga të dy anët e lumit Nil ndodhet shkretëtira, kurse lumi në luginën e tij mundëson tokë pjellore.
- Nil kalon nëpër shkretëtirë. Lugina e Nilit është tokë shumë pjellore e përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme.

38. Përgjigje e dëshirueshme: Deti Adriatik ka rëndësi të shumëfishtë si resurs natyror. Për shkak të veçorive klimatike dhe plazheve me rërë bën pjesë ndër destinimet turistike më tërheqëse të Europës. Është i përshtatshëm për komunikacion detar, është pjesë e Detit të Mesdheut, si njërit nga detet më të frekuentuar në botë.

Përgjigje të dëshirueshme 1 pikë

- Deti Adriatik ka rëndësi të shumëfishtë si resurs natyror.
- Deti Adriatik është i rëndësishëm për ekonominë tonë.
- Për shkak të veçorive klimatike dhe plazheve me rërë bën pjesë ndër destinacionet turistike

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

më tërheqëse të Europës.

- Rëndësia ekonomike ka për zhvillim turizmin.
- Klima dhe plazhet mundësojnë zhvillimin e turizmit.
- Është i përshtatshëm për komunikacion detar.
- Është i përshtatshëm për fitimin e kripës, peshkut dhe formave tjera të ekonomisë detare.
- Për peshkatari dhe fitimin e kripës.
- Për zhvillimin e ndërtimtarisë së anijeve.

Përgjigje të dëshirueshme 2 pikë

- Deti Adriatik ka rëndësi të shumëfishtë si resurs natyror. Për shkak të veçorive klimatike dhe plazheve me rërë bën pjesë në destinimet më tërheqëse të turizmit të Europës.
- Deti Adriatik është resurs ekonomik, kurse është më i rëndësishmi për zhvillimin e turizmit.
- Është i përshtatshëm për komunikacion detar, është pjesë e Detit Mesdhe, si njërit nga detet më të frekuentuar në botë.
- Rëndësia ekonomike ka për zhvillim turizmin, kurse është i përshtatshëm për komunikacion detar.
- Deti Adriatik ka rëndësi të shumëfishtë si resurs natyror, kurse në veçanti është i përshtatshëm për komunikacion detar.
- I përshtatshëm për komunikacion detar, dhe për fitimin e kripës, peshkut dhe formave tjera të ekonomisë detare.
- Deti Adriatik ka rëndësi të shumëfishtë si resurs natyror, në veçanti për fitimin e kripës, peshkut dhe formave tjera të ekonomisë detare.
- Për shkak të veçorive klimatike dhe plazheve me rërë bën pjesë në destinacionet turistike më tërheqëse të Europës, por fitimi i kripës, peshkut dhe formave tjera të ekonomisë detare.
- Ka rëndësi ekonomike për zhvillimin e turizmit, Rëndësi ekonomike ka për zhvillimin e turizmit.

## KATALOGU I PROVIMIT - GJEOGRAFI

## Përgjigje të dëshirueshme 3 pikë

- Deti Adriatik ka rëndësi të shumëfishtë si resurs natyror. Për shkak të veçorive klimatike dhe plazheve me rërë bën pjesë në destinacionet turistike më tërheqëse të Europës. Është i përshtatshëm për komunikacion ujor.
- Deti Adriatik ka rëndësi të shumëfishtë si resurs natyror, ka rëndësi ekonomike për zhvillimin e turizmit, është i përshtatshëm për komunikacion ujor.
- Deti Adriatik ka rëndësi të shumëfishtë si resurs natyror, ka rëndësi ekonomike për zhvillimin e turizmit, dhe për fitimin e kripës, peshkut dhe formave tjera të ekonomisë detare.
- Ka rëndësi ekonomike për zhvillimin e turizmit, është i përshtatshëm për komunikacion rrugor dhe për fitimin e kripës, peshkut dhe formave tjera të ekonomisë detare.

## Përgjigje të mundshme 4 pikë

- Deti Adriatik ka rëndësi të shumëfishtë si resurs natyror. Për shkak të veçorive klimatike dhe plazheve me rërë bën pjesë ndër destinacionet turistike më tërheqëse të Europës. Është i përshtatshëm për komunikacion detar, është pjesë e Detit të Mesdheut, si njërit nga detet më të frekuentuar në botë.
- Për shkak të veçorive klimatike dhe plazheve me rërë bën pjesë në destinacionet turistike më tërheqëse të Europës. Është i përshtatshëm për komunikacion detar, është pjesë e Detit të Mesdheut, si njërit nga detet më të frekuentuar në botë. Është i përshtatshëm për fitimin e kripës, peshkut dhe formave tjera të ekonomisë detare.
- Deti Adriatik ka rëndësi të shumëfishtë si resurs natyror. Për shka të veçorive klimatike dhe plazheve me rërë bën pjesë në destinacionet turistike më tërheqëse të Europës. Është i përshtatshëm për komunikacion detar. Është i përshtatshëm për fitimin e kripës, peshkut dhe formave tjera të ekonomisë detare.
- Deti Adriatik ka rëndësi të shumëfishtë si resurs ekonomik. Për shkak të veçorive klimatike dhe plazheve me rërë bën pjesë në destinacionet turistike më tërheqëse të Europës. Është pjesë e Detit të Mesdheut, si njërit ndër detet më të frekuentuar në botë. Është i përshtatshëm për fitimin e kripës, peshkut dhe formave tjera të ekonomisë detare.

Të 5 pikët nëse është dhënë përgjigjja e dëshiruar ose nëse janë përfshirë të gjithë elementet e rëndësishme, me rëndësi të veçantë resursi natyror, zhvillimi i turizmit, klimës dhe plazhit, komunikacioni detar, pjesë e Detit të Mesdheut i përshtatshëm për komunikacion, prodhim të kripës e peshkut dhe formave tjera të ekonomisë detare.

## 8. LITERATURA THEMELORE

Për nxënësit që të përgatitën për provim:

- Millutin Tadiq, Vesna Kekoviq- Gjeografia për klasën VI të shkollës fillore, Enti për Tekste dhe Mjete Mësimore, Podgoricë, 2007.
- Millutin Tadiq, Urosh Rakiq, Vesna Kekoviq- Gjeografia për klasën VII të shkollës fillore, Enti për Tekste dhe Mjete Mësimore, Podgoricë, 2009.
- Millutin Tadiq, Urosh Rakiq, Daniella Neshovska- Gjeografia për klasën VIII të shkollës fillore, Enti për Tekste dhe Mjete Mësimore, Podgoricë, 2009.
- Millutin Tadiq, Gojko Nikoliq, Osman Grgureviiq- Gjeografia për klasën XIX të shkollës fillore, Enti për Tekste dhe Mjete Mësimore, Podgoricë, 2009.